

**RAPORT MONITORIMI I PLANIT TË
VEPRIMIT TË PLANIT TË
INTEGRITETIT
TË MINISTRISË SË PUNËVE TË
BRENDSHME 2025-2028**

KORRIK-DHJETOR 2025

Përmbajtja e lëndës:

1.1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1.2 PROGRESI PËR PERIUDHËN KORRIK-DHJETOR 2025	6
OBJEKTIVI 1: RITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE.....	6
1.1 Konflikti i interesit me operatorët ekonomikë	6
1.2 Qasja subjektive dhe e qëllimshme në hartimin e dokumenteve të prokurimit.....	7
1.3 Dhënia e informacionit konfidencial tek operatorët ekonomikë me qëllime favorizuese.....	7
1.4 Vlerësimi subjektiv i ofertave dhe shqyrtimi subjektiv i ankesave	7
1.5 Mosrespektimi i procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime	7
OBJEKTIVI 2: RITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E INSPEKTIMEVE, LËSHIMIT TË LICENCAVE DHE CERTIFIKIMEVE.....	8
2.1 Miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në kundërshtim me përcaktimet ligjore	8
2.2 Moskryerja e inspektimeve në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor	9
2.3 Mos shqyrtimi në kohë i aplikimeve nga shtetas të ndryshëm për fitimin/lënien/rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe kontrolli i zbatimit të procedurave brenda afateve ligjore	9
2.4 Vonesa në raportim apo statistika të gabuara nga përpunimi dhe analizimi i të dhënave statistikore, me qëllim hartimin e informacionit përfundimtar të statistikave	10
2.5 Mosbashkëpunimi/koordinimi me Shërbimin Informativ të Shtetit, Policinë e Shtetit, Drejtoritë Vendore të Policisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për verifikimin të kërkesave të fitimit dhe rifitimit të shtetësisë	10
2.6 Paqartësi në procedurat e aplikimit	11
2.7 Përdorimi i teknikave të papërshtatshme për vlerësimin e kërkesave.....	11
OBJEKTIVI 3: RITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE	11
3.1 Zbatimi i politikave të integritetit dhe etikës për stafin	12
3.2 Rekrutimi i punonjësve në shkelje të kritereve ligjore të veçanta dhe procedurave të pranimit të tyre mbi baza preferencialë.....	12
3.3 Krijimi i një atmosfere bashkëpunuese dhe pozitive në vendin e punës	13
3.4 Intensifikimi i trajnimeve për nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative si një ndër komponentët në vlerësimin e veprimtarisë administrative dhe përgatitja e programeve të trajnimit bazuar në risitë dhe zhvillimet ligjore.	13

3.5 Mungesa e mekanizmave në rregullimin e veprimtarisë për vlerësimin e aftësive profesionale dhe etike të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.	13
3.6 Mungesa e zbatimit të procedurave të miratuara në rekrutimin apo moszbatimi i tyre në rekrutimin e punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi si dhe dhënie e gradave për strukturat e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.....	14
3.7 Mungesa e trajnimit i stafit.....	14
3.8 Mungesa e informacionit publik për këshilltarët politikë, profilizimin dhe veprimtarinë e tyre.....	14
OBJEKTIVI 4: RRITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT FINANCIAR, ASETEVE DHE PROJEKTEVE	15
4.1 Riallokimet e shpeshta të fondeve buxhetore midis programeve ose njësive shpenzuese gjatë vitit buxhetor, shpesh si reagime ndaj vonesave, planifikimit të pamjaftueshëm apo prioritetëve të paqëndrueshme, kjo krijon një pasiguri në zbatimin e projekteve dhe ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të planifikuara.....	16
4.2 Shpërndarja e buxhetit jo në përputhje me prioritetet e qeverisë	16
4.3 Mungesa e transparencës në planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër të shpenzimeve.....	16
4.4 Vonesat në procedurat e prokurimit	17
4.5 Mungesa e regjistrimit të plotë dhe të saktë të pronave publike, si dhe mekanizmave efektivë për administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e tyre, krijon risk për përdorim të paautorizuar, humbje fizik apo juridike të pasurisë publike dhe mungesës të të ardhurave ose shfrytëzimit të tyre.	17
4.6 Sistemi joefikas i monitorimit të ecurisë së projekteve për shkak të mungesës ose vonesave në raportimet periodike nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme	17
OBJEKTIVI 5: RRITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E ARKIVIMIT, RUAJTJES SË DOKUMENTACIONIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË KLASIFIKUAR.....	18
5.1 Mungesa e unifikimit të procedurave që do të lehtësojnë veprimtarinë e nëpunësve të zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, referuar rasteve të ndeshura në praktikë me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj shtetasve	19
5.2 Mungesa e inventarizimit të plotë të akteve të gjendjes civile të administruara nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative	19
5.3 Aksesit në dokumente të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, nga punonjës pa certifikatë sigurie për nivelin përkatës	19
5.4 Nxjerrje e sekretit për informacione të klasifikuara “Sekret Shtetëror”	19
5.5 Përmirësimi i menaxhimit të dosjeve	20

OBJEKTIVI 6: RRITJA E INTEGRITETIT PËRMES TRANSPARENCËS SË SHITUAR DHE TË PLOTË INSTITUCIONALE	20
6.1 Krijimi i situatave favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale.....	21
6.2 Humbja e besimit në opinionin publik.....	21
6.3 Dhënia e informacioneve konfidenciale personave të paautorizuar gjatë procesit gjyqësor .	21
6.4 Mungesa e informacionit të plotë ose kontradiktor dhe mos përgjigjja nga disa struktura..	21
6.5 Mungesa e bashkëpunimit efektiv dhe dhënia e informacionit jo të plotë për qytetarët	21
6.6 Mungesa e një faqeje zyrtare të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) .	21
6.7 Trajtimi i rasteve përmes platformës “Për Shqipërinë që Duam” dhe adresimi i vonësve nga e-Albania	22
6.8 Ndërhyrje e jashtme në procedurat e shqyrtimit të kërkesave për azil.....	22
OBJEKTIVI 7: RRITJA E INTEGRITETIT PËRMES KOORDINIMIT NË HARTIMIN DHE KUADRIN LIGJOR DHE STRATEGJIK	22
7.1 Mosrealizimi në kohë i raporteve periodike të monitorimit në zbatim të Strategjive Kombëtare /Ndërsektoriale	23
1.3 REKOMANDIME DHE KONKLUSIONE.....	23
1.3.1 KONKLUSIONE.....	23

1.1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në kuadër të angazhimeve të Ministrisë së Punëve të Brendshme për forcimin e qeverisjes së mirë dhe rritjen e standardeve të integritetit në administratën publike, si dhe në zbatim të Objektivit 1.2 *“Forcimi i transparencës, llogaridhënies dhe integritetit të institucioneve publike në të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore”*, të parashikuar në Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Planin e saj të Veprimit 2024–2026, Ministri i Brendshëm, përmes urdhrit nr. 114, datë 18.07.2025, miratoi Planin e Integritetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme 2025–2028 dhe Planin shoqërues të Veprimit 2025–2028.

Plani i Integritetit **mbështetet në 7 objektiva specifike, 40 fusha me risk dhe 72 masa/aktivitete**, të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit procedural, forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, rritjen e kapaciteteve profesionale të personelit dhe zgjerimin e transparencës institucionale. Ky dokument strategjik përbën një ndër komponentët e transparencës institucionale, veçanërisht lidhur me aspektet e informimit të publikut, përmes publikimit të raporteve të monitorimit dhe vlerësimit të strategjive ndërsektoriale dhe kombëtare, dokumenteve të hartuara nga strukturat përgjegjëse për politikën, si dhe publikimin e informacionit për funksionarët publik, këshilltarët, raportet e performancës dhe proceset e rekrutimit.

Fushat me risk të shtuar për cenim të integritetit përfshijnë:

- Rritja e integritetit në fushën e menaxhimit të shërbimeve mbështetëse dhe prokurimeve publike;
- Rritja e integritetit në fushën e inspektimeve, kontroleve, lëshimit të licencave dhe certifikimeve;
- Rritja e integritetit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Rritja e integritetit në fushën e menaxhimit financiar, aseteve dhe projekteve;
- Rritja e integritetit në fushën e arkivimit, ruajtjes së dokumentacionit dhe administrimit të informacionit të klasifikuar;
- Rritja e integritetit përmes transparencës së shtuar dhe të plotë institucionale;
- Rritja e integritetit përmes përmirësimit të koordinimit në hartimin, monitorimin dhe përditësimin e kuadrit ligjor dhe strategjik.

Plani synon krijimin e një mekanizmi të qëndrueshëm parandalues, i cili siguron identifikimin, vlerësimin, minimizimin dhe eliminimin sistematik të faktorëve që mund të cenojnë integritetin institucional, përmes vendosjes së proceseve të standardizuara të menaxhimit të riskut, forcimit të kontrollit të brendshëm dhe aplikimit të masave korrigjuese dhe parandaluese. Ky mekanizëm synon të garantojë funksionimin e një sistemi të integruar të monitorimit të vazhdueshëm, transparencës, llogaridhënies dhe kulturës etike në ushtrimin e funksioneve publike, duke parandaluar shfaqjen e praktikave të papërshtatshme, keqadministrimit, konfliktit të interesit dhe çdo forme tjetër sjelljeje që mund të ndikojë negativisht në integritetin e institucionit.

Në zbatim të pikës 3 të urdhrit nr. 114, strukturat e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme raportojnë periodikisht, sipas përcaktimeve të Planit të Veprimit 2025–2028, mbi nivelin e zbatimit të objektivave dhe masave përkatëse. Ky proces monitorimi dhe vlerësimi realizohet me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të caktuar nga të gjitha strukturat përgjegjëse.

Zbatueshmëria e masave dhe aktiviteteve të Planit të Veprimit klasifikohet sipas vlerësimit të mëposhtshëm:

- **E realizuar:** Strukturat kanë raportuar statusin “E realizuar” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.
- **Pjesërisht e realizuar/Në proces:** Institucionet kanë raportuar statusin “Në proces” për ato masa/aktivitete, të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- **E porealizuar:** Të pazbatuara janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese si dhe gjithashtu ato masa/aktivitete për të cilat nuk është përcjellë raportim nga strukturat/institucionet përgjegjëse.

Në zbatim të pikës 4 të urdhrit nr. 114, *“Pika e Kontaktit për Çështjet e Integritetit është përgjegjëse për koordinimin, mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e raportimeve të strukturave të aparatit”*, pas koordinimit, mbledhjes, përpunimit të të dhënave dhe analizimeve të raportimeve nga strukturat e aparatit u hartua Raporti i Monitorimit për gjashtëmuajorin e dytë të vitit 2025. Përfundimet e analizës identifikuan nivelin e realizimit të masave, si dhe vlerësuan ndikimin e zbatimit të masave në forcimin e integritetit institucional. Për masat e pazbatuara ose në proces zbatimi u përcaktuan rekomandimet për strukturat përgjegjëse. Gjetjet e raportit evidentojnë progres në drejtim të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë institucionale, veçanërisht në fushat e prokurimit publik, menaxhimit të burimeve njerëzore, menaxhimit financiar dhe ofrimit të shërbimeve publike konkretisht,

1.2 PROGRESI PËR PERIUDHËN KORRIK-DHJETOR 2025

OBJEKTIVI 1: RITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE PUBLIKE

Objektivi i rritjes së integritetit në fushën e prokurimit publik synon forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe ndershmërisë në proceset e prokurimit, me qëllim minimizimin e hapësirave për korrupsion dhe abuzim. Ky objektivi mundëson krijimin e një sistemi të drejtë dhe efikas, i cili garanton trajtim të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit në procedurat e prokurimit dhe siguron përdorimin optimal të burimeve publike.

Në kuadër të këtij objektivi janë parashikuar masa specifike me karakter organizativ, parandalues, formues dhe monitorues, të cilat synojnë jo vetëm minimizimin e ndikimit të risqeve në procesin e prokurimit publik, por edhe forcimin e integritetit, rritjen e transparencës dhe garantimin e një trajtimi të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës. Gjithashtu, këtu përfshihen edhe përmirësimi i mekanizmave të monitorimit për proceset e prokurimit dhe zhvillimi i procedurave të standardizuara që rrisin transparencën në çdo fazë të procesit, nga planifikimi deri në zbatimin e kontratave.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **5 fusha me risk**, për të cilat janë planifikuar **9 masa specifike**, të zbatuara nga struktura përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse.

Në kuadër të rritjes së integritetit në fushën e prokurimit publik, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim, të cilat pasqyrojnë përmbushjen e masave të parashikuara në Planin e Veprimit:

- Respektimi i parimeve dhe rregullave të prokurimit publik nga struktura përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- Hartimi, vlerësimi dhe shqyrtimi i procedurave të prokurimit publik në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Reduktimi i rasteve të denoncuarra për praktika abuzive;
- Përmirësimi i njohurive mbi zbatimin e procedurave të reja, ndryshimeve ligjore për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, nga anëtarët e komisioneve të prokurimit publik;
- Rritja e qëndrueshmërisë së anëtarëve të komisioneve, bazuar në kritere të qarta vlerësimi dhe mekanizma kontrolli të brendshëm dhe të jashtëm;
- Zhvillimi i trajnimeve periodike për punonjësit, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale dhe njohurive ligjore për një interpretim dhe zbatim të saktë të kuadrit ligjor;
- Rritja e transparencës në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, ku çdo procedurë është shoqëruar me deklarata të konfliktit të interesit, duke garantuar trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë dhe respektimin e konkurrencës së lirë.

1.1 Konflikti i interesit me operatorët ekonomikë

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara, si dhe monitorimit të vazhdueshëm nga struktura përgjegjëse të Shërbimeve Mbështetëse, për periudhën e raportimit nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit, **duke rezultuar në 0 (zero) raste të raportuara.**

Parandalimi i konfliktit të interesit në procedurat e prokurimit publik sigurohet përmes plotësimit të detyrueshëm të deklaratës së konfliktit të interesit për çdo procedurë, si në fazën e studimit të tregut ashtu edhe gjatë vlerësimit të ofertave, si dhe përmes trajnimit periodik dhe të detyrueshëm për rritjen e nivelit profesional të punonjësve të angazhuar në realizimin e procedurave të prokurimit publik. **Gjatë periudhës së raportimit janë trajnuar 2 punonjës për procedurat e prokurimit publik dhe 3 punonjës kanë ndjekur trajnimin “Prezantimi me administratën publike”.**

1.2 Qasja subjektive dhe e qëllimshme në hartimin e dokumenteve të prokurimit

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën e raportimit, struktura përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse ka raportuar se nuk janë identifikuar apo denoncuar raste të hartimit abuziv apo subjektiv të dokumenteve të prokurimit, duke rezultuar në **0 (zero) raste të regjistruara.**

Garantimi i objektivitetit sigurohet përmes forcimit të pavarësisë së anëtarëve të komisioneve të prokurimit dhe kufizimit të diskrecionit të titullarëve, nëpërmjet zbatimit të kriterëve të qarta ligjore dhe mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm.

1.3 Dhënia e informacionit konfidencial tek operatorët ekonomikë me qëllime favorizuese

Ruajtja e konfidencialitetit në procedurat e prokurimit sigurohet përmes nënshkrimit dhe respektimit rigoroz të deklaratave të konfidencialitetit nga të gjithë punonjësit e përfshirë në këto procese, si dhe përmes zbatimit të detyrimeve që rrjedhin prej tyre. **Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar gjithsej 22 procedura prokurimi, prej të cilave 17 procedura për blerje të vogla dhe nën 100 000 lekë, si dhe 5 procedura për blerjen e biletave të transportit ajror.** Nga monitorimi i kryer nuk është regjistruar asnjë rast i denoncuar lidhur me shkelje të konfidencialitetit apo praktika të tjera të papërshtatshme në procedurat e prokurimit, **duke rezultuar në 0 (zero) raste të evidentuara.**

1.4 Vlerësimi subjektiv i ofertave dhe shqyrtimi subjektiv i ankesave

Parandalimi i vlerësimeve subjektive realizohet përmes përmirësimit të proceseve të hartimit dhe vlerësimit të dokumentacionit, përfshirjes së ekspertizës së duhur dhe respektimit të plotë të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi. Për periudhën e raportimit, nga auditimet e kryera nuk janë evidentuar gjetje që lidhen me vlerësim subjektiv të ofertave apo shqyrtim të njëanshëm të ankesave, si dhe nuk janë dhënë masa disiplinore, duke rezultuar në **0 (zero) raste të tilla.**

1.5 Mosrespektimi i procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve, për periudhën e raportimit janë trajnuar **2 (dy) punonjës** mbi respektimin e procedurave të prokurimit publik me vlerë të vogël për mallra dhe shërbime, ndërsa nga monitorimi i kryer nga struktura përgjegjëse e Shërbimeve Mbështetëse nuk janë evidentuar raste konkrete të shkeljes së procedurave të prokurimit, duke reflektuar **0 (zero) raste shkeljesh**.

Rritja e përputhshmërisë me procedurat e prokurimit publik me vlerë të vogël sigurohet përmes përmirësimit të specifikimeve teknike, zhvillimit të studimeve dhe analizave të tregut, si dhe përmirësimit të njohurive profesionale të anëtarëve të komisioneve të prokurimit në lidhje me ndryshimet ligjore, në këtë fushë.

OBJEKTIVI 2: RITJIA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E INSPEKTIMEVE, LËSHIMIT TË LICENCAVE DHE CERTIFIKIMEVE

Objektivi i rritjes së integritetit në fushën e inspektimeve, kontrolleve dhe lëshimit të licencave dhe certifikimeve synon forcimin e integritetit institucional dhe minimizimin e rreziqeve të korrupsionit në këto procese. Ky objektivi kontribuon në rritjen e transparencës, efikasitetit dhe besueshmërisë së proceseve administrative, duke ndihmuar në ndërtimin e një administrate publike më të përgjegjshme dhe në përputhje me standardet evropiane.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **7 fusha me risk**, për të cilat janë planifikuar **13 masa specifike**, të zbatuara nga struktura përgjegjëse për Politikën e Shtetësisë, struktura përgjegjëse për Politikën e Azilit, Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH).

Në kuadër të zbatimit të masave për këtë objektivi, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim:

- Kryerja e inspektimeve në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor;
- Shqyrtimi në kohë të aplikimeve për fitimin, lënien dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe respektimi i afateve ligjore të procedurave nga struktura përgjegjëse për politikën e Shtetësisë;
- Kryerja e raportimeve periodike dhe përpunimit të të dhënave statistikore brenda afateve ligjore nga struktura përgjegjëse për politikën e shtetësisë;
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet strukturës përgjegjëse për Politikën e Shtetësisë dhe institucioneve partnere për verifikimin e kërkesave për fitim dhe rifitim të shtetësisë.
- Procedura më të qarta për aplikimin nga azilkërkuesi t përmes vendosjes së fletëpalosjeve informuese në gjuhë të ndryshme në ambientet e strukturave përkatëse si dhe vendosja në dispozicion edhe lidhje (link-e) informative në internet për aksesim.

2.1 Miratimi i dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin në kundërshtim me përcaktimet ligjore

Përgjatë periudhës së raportimit, struktura përgjegjëse për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin raporton se kuadri ligjor dhe nënligjor në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit paraqitet i qëndrueshëm, me përgjegjësi të përcaktuara qartë dhe në mënyrë hierarkike, në zbatim të ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. **Gjatë periudhës korrik–dhjetor 2026, numri i inspektimeve të kryera në nivel vendor rezulton 2,432.**

Gjithashtu, si rezultat i miratimit të ligjit nr. 99/2024, datë 12.09.2024, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, DPMZSH nuk ushtron më funksione inspektuese. Ky funksion i është atribuuar strukturave vendore të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të cilat veprojnë në varësi të kryetarëve të bashkive.

2.2 Moskryerja e inspektimeve në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën e raportimit, janë zhvilluar trajnime periodike për punonjësit e inspektimit të parandalimit, me qëllim rritjen e aftësive profesionale dhe përmirësimin e njohurive ligjore. Këto trajnime janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme pranë Akademisë së Sigurisë. Sipas planifikimit për vitin 2025, **në Akademinë e Sigurisë janë organizuar kurse për punonjësit e strukturave vendore të MZSH-së**, ku morën pjesë dhe u certifikuan:

- **60 punonjës në kursin dyjavor për gradën “Asistent Zjarrfikës” gjatë periudhës prill-maj 2025;**
- **22 punonjës në kursin njëjavor për gradën “Kryezjarrfikës” gjatë periudhës 26 – 30 maj 2025;**
- **24 punonjës në kursin njëjavor për gradën “Zjarrfikës” gjatë periudhës 13 – 17 tetor 2025;**
- **32 punonjës në kursin dyjavor për gradën “Asistent Zjarrfikës” gjatë periudhës 10 – 21 nëntor 2025;**
- **17 punonjës në kursin njëjavor për gradën “Inspektor Zjarrfikës” gjatë periudhës 1 – 5 dhjetor 2025.**

2.3 Mos shqyrtimi në kohë i aplikimeve nga shtetas të ndryshëm për fitimin/lënien/rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe kontrolli i zbatimit të procedurave brenda afateve ligjore

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara, procedurat për trajtimin e aplikimeve për fitimin, lënien apo rifitimin e shtetësisë shqiptare zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe përfshijnë verifikime ndërinstitutionale.

Çdo zgjatje e mundshme e afateve lidhet me kohën e përgjigjes nga institucionet partnere dhe nuk është rezultat i mosveprimit të strukturës përgjegjëse. Aplikimet depozitohen nga Drejtoritë Vendore të Policisë ose përmes përfaqësive diplomatike dhe shqyrtohen nga struktura përgjegjëse për politikën e Shtetësisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, brenda afatit ligjor prej **45 ditësh**, afat i cili është respektuar në të gjitha rastet gjatë periudhës së raportimit.

procedurave të shqyrtimit administrativ, **262 kërkesa janë përcjellë për verifikim pranë organeve kompetente ligjzbatuese, përfshirë Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH) dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH)**, me qëllim kryerjen e verifikimeve të nevojshme sipas legjislacionit në fuqi.

2.6 Paqartësi në procedurat e aplikimit

Gjatë periudhës raportuese, pranë strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit dhe Qendrës Kombëtare për Pritjen e Azilkërkuesve, gjatë procesit të aplikimit nga azilkërkuesit janë vendosur fletëpalosje informuese në gjuhë të ndryshme, të hartuara dhe të financuara në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë, të cilat shërbejnë si ndihmë praktike për aplikantët. Gjithashtu, në ambientet përkatëse janë vënë në dispozicion edhe lidhje (link-e) informative në internet për aksesim nga aplikantët. **Gjatë periudhës korrik–dhjetor 2025, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Qendrës Kombëtare për Pritjen e Azilkërkuesve nuk janë regjistruar ankesa nga azilkërkuesit lidhur me mungesën e udhëzuesve, manualeve, sqarimeve apo informacionit mbi procedurat e aplikimit për azil.**

2.7 Përdorimi i teknikave të papërshtatshme për vlerësimin e kërkesave

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve struktura përgjegjëse për Politikën e Azilit raporton se numri i stafit të trajnuar në metodat ndërkombëtare të vlerësimit dhe intervistimit rezulton **4 (katër)** punonjës.

OBJEKTIVI 3: RITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Objektivi i ritjes së integritetit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore synon forcimin e integritetit institucional dhe eliminimin e rreziqeve të korrupsionit në proceset e menaxhimit të burimeve njerëzore. Ky objektivi synon gjithashtu garantimin e transparencës dhe llogaridhënies në proceset e rekrutimit, gradimeve dhe administrimit të burimeve njerëzore, duke kontribuar në ndërtimin e një administrate publike të përgjegjshme dhe profesionale, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet kombëtare për integritet dhe luftë kundër korrupsionit.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **8 fusha me risk**, për të cilat janë planifikuar **15 masa specifike** që zbatohen nga strukturat si më poshtë:

- struktura përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH).

Në kuadër të zbatimit të masave për këtë objektivi, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim:

- Zbatimi i politikave të integritetit dhe etikës për stafin;

- Rekrutimi i punonjësve sipas kriterëve të legjislacionit në fuqi;
- Krijimi i një atmosfere bashkëpunuese dhe pozitive në vendin e punës;
- Publikimi i informacionit mbi këshilltarët politikë, profilizimin dhe veprimtarinë e tyre në faqen zyrtare të institucionit;
- Zhvillimi i trajnimeve intensive për nëpunësit e gjendjes civile, me fokus në përditësimet e legjislacionit në fuqi.

3.1 Zbatimi i politikave të integritetit dhe etikës për stafin

Në kuadër të zbatimit të politikave të Planit të Integritetit janë parashikuar masa dhe aktivitete për parandalimin dhe menaxhimin e risqeve në fushën e burimeve njerëzore, përmes njohjes me bazën ligjore dhe nënligjore për etikën dhe integritetin, si dhe zhvillimit të trajnimeve dhe këshillimeve për stafin.

Përgjatë kësaj periudhe struktura përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka informuar punonjësit e emëruar rishtazi, nëpërmjet postës elektronike mbi bazën ligjore të detyrueshme për t'u zbatuar gjatë dhe pas ushtrimit të detyrave funksionale, si dhe mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, pas fillimit të marrëdhënieve të punës. Gjithashtu, përveç njohjes formale me bazën ligjore, është ofruar këshillim dhe sqarim verbal rast pas rasti për stafin aktual dhe atë të rekrutuar rishtazi.

Gjatë periudhës korrik–dhjetor 2025, në aparatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme janë punësuar gjithsej 20 punonjës. Prej tyre, 6 punonjës janë pjesë e shërbimit civil, ku përfshihen 2 punonjës të Trupës së Nivelit të Lartë Drejtues (TND), 1 punonjës i emëruar nëpërmjet lëvizjes paralele në kategorinë ekzekutive, 1 punonjës i emëruar me ngritje në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese dhe 1 punonjës i transferuar përkohësisht në kategorinë ekzekutive. Gjithashtu janë emëruar 12 punonjës në pozicione politike, përkatësisht 1 Ministër, 2 Zëvendësministra, 1 Drejtor Kabineti, 6 Këshilltarë dhe 2 Sekretare të Zëvendësministrit. Ndërkohë janë punësuar edhe 2 punonjës administrativë, konkretisht 1 Sekretare e Sekretarit të Përgjithshëm dhe 1 punonjëse mirëmbajtje.

3.2 Rekrutimi i punonjësve në shkelje të kriterëve ligjore të veçanta dhe procedurave të pranimit të tyre mbi baza preferencialë

Për periudhën gjashtëmujore të dytë të vitit 2025, struktura përgjegjëse për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka hartuar planin e nevojave për rekrutim, duke identifikuar vendet vakante për strukturat e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ky plan i është përcjellë Departamentit të Administratës Publike, i shoqëruar me kriteret përkatëse të përcaktuara në përshkrimet e punës, në përputhje me rregulloren e brendshme të institucionit dhe në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore në fuqi.

Në vijim të procedurave të ndjekura është zbatuar akti i emërimit për aplikantin e shpallur fitues, në përputhje me legjislacionin për shërbimin civil.

Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur vende vakante me kod pune për pozicione mbështetëse në aparatën e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

3.3 Krijimi i një atmosfere bashkëpunuese dhe pozitive në vendin e punës

Përgjatë periudhës së raportimit nga struktura përgjegjëse e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore janë identifikuar dhe adresuar nevojat për trajnim të stafit, të cilat i janë përcjellë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA). **Punonjësit kanë marrë pjesë në trajnime të organizuara nga ASPA dhe në trajnime të tjera brenda dhe jashtë vendit, sipas fushës së përgjegjësisë, ku në total punonjësit kanë marrë pjesë në rreth 67 trajnime.** Për periudhën e raportimit me qëllim krijimin e një atmosfere pozitive është realizuar një aktivitet social për fëmijët e punonjësve, me rastin e festave të fundvitit.

Për sa i përket aplikimit të orarit fleksibël për punonjësit e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ju informojmë se, pas ndryshimeve të VKM-së nr. 568, datë 06.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompensimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore"*, është njoftuar stafi për mundësinë e aplikimit të orarit fleksibël, duke u bërë me dije se, orari i detyrueshëm, kur të gjithë të punësuarit duhet të jenë në vendet e punës, nga e hëna në të enjte, është 9:30 – 15:30, ndërsa ditën e premte 9:30 – 13:00, si dhe plotësimi i detyrueshëm i 8.5 orë punë në ditë nga e hëna në të enjte dhe 6 orë në ditë ditën e premte dhe u kërkua të planifikohet orari i punës që do të zgjidhej nga secili punonjës.

Në vijim u miratua tabela me orarin e punës për 134 punonjës, 69 prej të cilëve zgjodhën një orar fleksibël dhe 65 zgjodhën orarin 08:00 – 16:30 nga e hëna në të enjte dhe 08:00 – 14:00 të premten. Në lidhje me zbatimin e orarit fleksibël të miratuar **nuk ka pasur problematika.** Gjatë periudhës raportuese nuk janë realizuar takime apo anketa për kënaqësinë e punonjësve.

3.4 Intensifikimi i trajnimeve për nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative si një ndër komponentët në vlerësimin e veprimtarisë administrative dhe përgatitja e programeve të trajnimit bazuar në risitë dhe zhvillimet ligjore.

Në zbatim të masave/aktiviteteve të planifikuara, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka vijuar zhvillimin e trajnimeve në nivel qarku për nëpunësit e zyrave të gjendjes civile në bashki dhe njësi administrative bazuar në risitë dhe zhvillimet ligjore. **Trajnime janë zhvilluar për qarqet Vlorë, Elbasan, Kukës dhe Dibër, me objekt "Regjistrimi i eventeve vitale", me mbështetjen e INSTAT.**

Gjithashtu, janë organizuar trajnime me fokus "Modalitetet dhe përdorimi i sistemit të përmirësuar të RKGjC-së", në të cilat janë trajnuar 524 nëpunës të shërbimit të gjendjes civile.

3.5 Mungesa e mekanizmave në rregullimin e veprimtarisë për vlerësimin e aftësive profesionale dhe etike të nëpunësve të shërbimit të gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut.

Përmes masave dhe aktiviteteve të planifikuara synohet përgatitja e akteve që parashikojnë tregues të qartë performance për ushtrimin e veprimtarisë së nëpunësve të gjendjes civile, në funksion të rritjes së integritetit në menaxhimin e burimeve njerëzore. **Realizimi i kësaj mase është planifikuar të realizohet gjatë gjashtëmujorit të dytë të vitit 2026.**

3.6 Mungesa e zbatimit të procedurave të miratuara në rekrutimin apo moszbatimi i tyre në rekrutimin e punonjësve të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi si dhe dhënie e gradave për strukturat e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi.

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara, procesi i zhvillimit të burimeve njerëzore në Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH) trajtohet si një proces i vazhdueshëm i rritjes së njohurive, aftësive dhe kapaciteteve profesionale të personelit, në përputhje me ligjin nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” dhe aktet nënligjore në fuqi, të cilat rregullojnë procedurat e rekrutimit dhe ecurinë në karrierë sipas sistemit të gradave.

Gjatë periudhës së raportimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së është konstatuar se zbatimi i procedurave të rekrutimit dhe dhënia e gradave realizohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe në linjë me procesin e administrimit të burimeve njerëzore përmes sistemit AMS. Në këtë kuadër nuk janë evidentuar raste të moszbatimit të procedurave të miratuara.

Për periudhën e raportimit 2025 janë dhënë grada për 91 punonjës të nivelit bazë të shërbimit zjarrfikës, të cilët kanë përfunduar me sukses trajnimet përkatëse në Akademinë e Sigurisë. Konkretisht, grada “Kryezjarrfikës” është akorduar për 22 punonjës, grada “Zjarrfikës” për 24 punonjës dhe grada “Asistent Zjarrfikës” për 45 punonjës. Këto gradime janë realizuar në përputhje me përfundimin e programeve të formimit profesional, duke kontribuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe përparimin në karrierë të punonjësve të shërbimit zjarrfikës.

3.7 Mungesa e trajnimit i stafit

Gjatë periudhës së raportimit, trajnimi i stafit është realizuar në mënyrë të vazhdueshme, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e nivelit të njohurive dhe aftësive profesionale të punonjësve. Njoftimet dhe ftesat për pjesëmarrje në trajnime janë trajtuar drejtpërdrejtë nga strukturat përkatëse, duke menaxhuar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e stafit në aktivitetet trajnuese. Në këtë aspekt mbetet problematikë krijimi i një mekanizmi/databazë për raportimin/regjistrimin e trajnimeve të kryera nga stafi për arsye të transparencës, mos përsëritjes së trajnimeve nga të njëjtët punonjës dhe planifikim më të mirë të shpërndarjes së trajnimeve ndërmjet stafit. Gjithashtu mbetet e rëndësishme edhe identifikimi i trajnimeve të realizuara me mbështetjen e organizatave kombëtare/ndërkombëtare dhe projekteve/partnerëve me të cilët Ministria e Punëve të Brendshme ka bashkëpunim.

3.8 Mungesa e informacionit publik për këshilltarët politikë, profilizimin dhe veprimtarinë e tyre

Gjatë periudhës raportuese CV-të e funksionarëve politik dhe nivel drejtues të sistemit civil janë përditësuar rregullisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me procedurat e brendshme dhe kërkesat për transparencë, duke sjellë garantimin e transparencës përmes publikimit të informacionit mbi profilizimin, veprimtarinë dhe fushën e përgjegjësisë së këshilltarëve politikë. Linku përkatës është i aksesueshëm në faqen zyrtare të institucionit:

<https://mb.gov.al/ministria/>

<https://mb.gov.al/albana-kociu/>

<https://mb.gov.al/kabineti-i-ministrit/>

OBJEKTIVI 4: RITJIA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E MENAXHIMIT FINANCIAR, ASETEVE DHE PROJEKTEVE

Objektivi i rritjes së integritetit në fushat e menaxhimit financiar, të aseteve dhe projekteve synon garantimin që përdorimi dhe administrimi i burimeve financiare dhe pasurive publike të realizohet në përputhje me rregulla dhe procedura të qarta ligjore. Ky objektivi ka gjithashtu për qëllim përmirësimin e proceseve administrative dhe menaxheriale, duke siguruar një përdorim më efikas, transparent dhe të përgjegjshëm të fondeve publike, në funksion të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së besimit publik në sistemin e menaxhimit financiar.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **6 fusha me risk**, për të cilat janë planifikuar në total **12 masa specifike**, të zbatuara nga:

- struktura përgjegjëse për buxhetin;
- struktura përgjegjëse për financën;
- struktura përgjegjëse për menaxhimin e aseteve;
- struktura përgjegjëse për menaxhimin e projekteve.

Në kuadër të zbatimit të masave për këtë objektivi, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim:

- Rritja e transparencës në planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër të shpenzimeve buxhetore;
- Respektimi i afateve ligjore në procedurat e prokurimit publik;
- Regjistrimi i saktë dhe i plotë i pronave publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe forcimi i mekanizmave për administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e tyre;
- Shpërndarja e buxhetit në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

- Edukimi dhe trajnimi i stafit me qëllim rritjen e efijencës në përdorimin e fondeve publike, përmirësimin e analizave dhe raporteve mbi risqet, si dhe reduktimin e numrit të rialokimeve krahasuar me vitin paraardhës;
- Përditësimi i vazhdueshëm i regjistrit të aktiveve për pronat dhe objektet në inventar, duke pasqyruar ndryshimet në administrim, pronësi, shitje apo privatizim.

4.1 Rialokimet e shpeshta të fondeve buxhetore midis programeve ose njësive shpenzuese gjatë vitit buxhetor, shpesh si reagime ndaj vonesave, planifikimit të pamjaftueshëm apo prioriteteve të paqëndrueshme, kjo krijon një pasiguri në zbatimin e projekteve dhe ndikojnë negativisht në realizimin e objektivave të planifikuara

Në bazë të vlerësimit të të dhënave mbi realizimin e shpenzimeve buxhetore, menaxhimi i fondeve është ndjekur në mënyrë sistematike përmes analizave periodike nga ana e strukturave përgjegjëse të buxhetit. Faktorët kryesorë që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit lidhen me mungesat në organikë, vonesat në procedurat e prokurimit dhe mosrealizimin në kohë të disa aktiviteteve të planifikuara. Problematikat e konstatuara janë trajtuar me qëllim shmangien e përsëritjes së tyre në vitet pasuese.

Për periudhën raportuese planifikimi buxhetor është hartuar mbi bazën e analizave të viteve paraardhëse, duke alokuar fondet sipas prioriteteve dhe kapaciteteve reale të realizimit. **Në këtë kuadër, janë hartuar raporte monitorimi mujor dhe tremujor, rialokimet janë kryer vetëm mbi bazë argumentimi të arsyetuar dhe për vitin buxhetor 2025 përqindja e rialokimeve është ulur në 10%, krahasuar me vitin 2024.**

4.2 Shpërndarja e buxhetit jo në përputhje me prioritetet e qeverisë

Përgjatë periudhës raportuese planifikimi buxhetor është harmonizuar me dokumentet strategjike dhe prioritetet qeveritare, ndërsa projektet dhe aktivitetet buxhetore janë monitoruar dhe rishikuar periodikisht për garantimin e përputhshmërisë me objektivat institucionale. Si rezultat, **90% e projekteve të financuara lidhen drejtpërdrejt me prioritetet strategjike**, ndërsa monitorimi i investimeve kryhet në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, është siguruar trajnimi i stafit nga Ministria e Financave për planifikimin e saktë buxhetor dhe vlerësimin e rishikimeve të planit vjetor.

4.3 Mungesa e transparencës në planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër të shpenzimeve

Në kuadër të rritjes së transparencës në planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër të shpenzimeve, në faqen zyrtare të institucionit realizohet publikimi periodik i planit buxhetor dhe i monitorimit të realizimit të buxhetit vjetor, duke garantuar transparencë në menaxhimin e shpenzimeve publike. Planifikimi i buxhetit kryhet në mënyrë të saktë dhe transparente nga drejtuesit e programeve buxhetore, në përputhje me legjislacionin financiar në fuqi.

Raportimi financiar dhe hedhja e të dhënave nga stafi përkatës realizohet përmes sistemeve financiare AFMIS dhe SIFQ, duke siguruar saktësi dhe shmangie të devijancave. Si rezultat, numri i raporteve buxhetore të publikuara brenda afatit ligjor është realizuar në masën **100%**. Nuk ka pasur ndryshime të personelit që kryen funksionin e përgatitjes së buxhetit.

4.4 Vonesat në procedurat e prokurimit

Në zbatim të masave/aktiviteteve, është forcuar bashkëpunimi me autoritetet kontraktore për respektimin e afateve kohore në çdo fazë të procesit të prokurimit, me qëllim shmangien e vonesave në procedurat për mallra, shërbime dhe investime, si dhe garantimin e realizimit të aktiviteteve sipas planifikimit buxhetor. Paralelisht, nga strukturat përgjegjëse janë hartuar dhe ndjekur regjistrat e prokurimeve, duke u siguruar njoftimi dhe pasqyrimi në kohë i çdo ndryshimi të mundshëm.

Këto masa dhe aktivitete kanë kontribuar në rritjen e efektivitetit të procesit të prokurimit dhe në përdorimin më eficient të fondeve publike, duke reduktuar rrezikun e vonesave dhe devijimeve nga objektivat e planifikuara.

4.5 Mungesa e regjistrimit të plotë dhe të saktë të pronave publike, si dhe mekanizmave efektivë për administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e tyre, krijon risk për përdorim të paautorizuar, humbje fizik apo juridike të pasurisë publike dhe mungesës të të ardhurave ose shfrytëzimit të tyre.

Në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën raportuese, nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e aseteve është hartuar regjistri i aktiveve sipas listës prioritare, si dhe është vijuar me përditësimin e vazhdueshëm të regjistrit të pronave dhe objekteve në inventar. Ky proces pasqyron në mënyrë të rregullt ndryshimet që lidhen me administrimin, ndryshimin e pronësisë, si dhe me transaksionet si shitja apo privatizimi i tyre.

4.6 Sistemi joefikas i monitorimit të ecuresë së projekteve për shkak të mungesës ose vonesave në raportimet periodike nga strukturat e Ministrisë së Punëve të Brendshme

Mungesa e një sistemi të konsoliduar monitorimi ka vështirësuar ndjekjen sistematike të ecuresë së projekteve dhe vlerësimin e gjendjes së tyre aktuale. Në këtë kuadër, është parashikuar hartimi i një plani pune për realizimin e vizitave monitoruese në terren për projektet me risk të lartë, si dhe zhvillimi i takimeve periodike me strukturat përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Në funksion të zbatimit të masave/aktiviteteve, struktura përgjegjëse e projekteve ka parashikuar në planin e punës për vitin 2026 realizimin e vizitave monitoruese në terren për projektet me risk. Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takime teknike dhe mbledhjet e Komiteteve Drejtuese dy herë në vit, në përputhje me kërkesat për zbatimin dhe monitorimin e projekteve. Konkretisht, gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar takimet e mëposhtme:

- Takimi i I-rë i Komitetit Kombëtar Drejtues – projekti kombëtar IPA III “EU4SAFE Albania” – 19 dhjetor 2025;
- Takimi i Komitetit Rajonal (RSC) – projekti IPA III “Mbështetje Rajonale e BE-së për Forcimin e Kapaciteteve të Sigurisë Kufitare në Ballkanin Perëndimor” – 11 mars 2025;
- Takimi i II-të i Komitetit Kombëtar Drejtues – projekti rajonal IPA III “EU4FAST” – 21 janar 2025;
- Takimi i III-të i Komitetit Kombëtar Drejtues – projekti rajonal IPA III “EU4FAST” – 30 tetor 2025;
- Takimi i I-rë i Komitetit Kombëtar Drejtues – projekti IPA III “EU4Migration Albania” – 12 qershor 2025;
- Takimi i II-të i Komitetit Kombëtar Drejtues – projekti rajonal IPA III “Mbështetje Rajonale për Mbrojtjen e Sistemeve të Menaxhimit të Migracionit të Ndjeshëm, në Ballkanin Perëndimor” – 17 shtator 2025;
- Takimi i II-të Rajonal (RSC) – projekti rajonal IPA III “Mbështetje Rajonale për Mbrojtjen e Sistemeve të Menaxhimit të Migracionit të Ndjeshëm, në Ballkanin Perëndimor” – 9 prill 2025.

OBJEKTIVI 5: RRITJA E INTEGRITETIT NË FUSHËN E ARKIVIMIT, RUAJTJES SË DOKUMENTACIONIT DHE ADMINISTRIMIT TË DOKUMENTACIONIT TË KLASIFIKUAR

Ky objektiv përqendrohet në parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit përmes përmirësimit të menaxhimit të informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara, sipas legjislacionit në fuqi. Ai synon gjithashtu krijimin e një mjedisi të sigurt për administrimin e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara, duke forcuar masat e sigurisë dhe duke përmirësuar integritetin e proceseve administrative, me qëllim parandalimin e keq menaxhimit dhe praktikave korruptive.

Për këtë objektiv janë identifikuar **5 fusha me risk**, për të cilat janë planifikuar gjithsej **10 masa specifike**, të cilat zbatohen nga struktura përgjegjëse për arkiv protokollin, struktura përgjegjëse për ankesat administrative dhe çështjet gjyqësore, struktura përgjegjëse për jetësimin e prioriteteve, struktura përgjegjëse për politikat e azilit, si dhe struktura të tjera të përfshira në parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në fushën e arkivimit, ruajtjes së informacionit dhe administrimit të dokumentacionit.

Gjatë periudhës së raportimit, në kuadër të zbatimit të masave për këtë objektiv janë arritur rezultatet kryesore si më poshtë:

- Unifikimi i procedurave, duke lehtësuar veprimtarinë e nëpunësve të zyrave të gjendjes civile;
- Fillimi i procesit të inventarizimit të plotë të akteve të gjendjes civile;
- Realizimi i trajnimeve për punonjësit e rinj lidhur me detyrimet që rrjedhin nga pajisja me certifikatë sigurie dhe menaxhimi i informacionit të klasifikuar;
- Përmirësimi i menaxhimit të dosjeve përmes sistemit të automatizuar nga struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit.

5.1 Mungesa e unifikimit të procedurave që do të lehtësojnë veprimtarinë e nëpunësve të zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative, referuar rasteve të ndeshura në praktikë me qëllim ofrimin e një shërbimi sa më cilësor ndaj shtetasve

Në kuadër të zbatimit të masave/aktiviteteve është parashikuar përgatitja e sqarimeve të hollësishme, manualeve të trajnimit të nevojshëm për veprimtarinë e nëpunësve të zyrave të gjendjes civile në bashki/njësi administrative. Në vijim nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, për periudhën e raportimit, janë dërguar orientime në mënyrë periodike që rregullojnë veprimtarinë e nëpunësve të gjendjes civile. Gjithashtu janë hartuar modelet e formateve për procesin e inventarizimit të dokumenteve që administrojnë zyrat e gjendjes civile në bashki /njësi administrative.

5.2 Mungesa e inventarizimit të plotë të akteve të gjendjes civile të administruara nga zyrat e gjendjes civile në bashki / njësi administrative

Në kuadër të zbatimit të masave/aktiviteteve është parashikuar ndjekja e procesit të inventarizimit në të gjitha fazat, duke filluar me përgatitjen e modeleve dhe formateve përkatëse të akteve, mbi bazën e të cilave zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative dhe zyrat e arkivës së gjendjes civile pranë prefektit të qarkut kanë iniciuar procesin e inventarizimit të akteve që administrojnë.

Për periudhën raportuese, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile është në proces të realizimit të kësaj veprimtarie. Aktualisht, zyrat e gjendjes civile po vijojnë inventarizimin e të gjitha akteve të administruara, në përputhje me modelet dhe formatin përkatës të dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

5.3 Aksesin në dokumente të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, nga punonjës pa certifikatë sigurie për nivelin përkatës

Me qëllim uljen e aksesit në dokumente të klasifikuara “Sekret Shtetëror”, nga punonjës pa certifikatë sigurie për nivelin përkatës, struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit, për periudhën e raportimit, ka ndjekur procesin e pajisjes së punonjësve me certifikatë sigurie dhe forcimin e kontroleve për administrimin e informacionit të klasifikuar. Nga të dhënat e raportuara rezulton se numri i punonjësve të pajisur me certifikatë sigurie është **2 (dy)**, numri i punonjësve që kanë aplikuar për pajisje me certifikatë sigurie është **1 (një)**, ndërsa numri i punonjësve të trajnuar në lidhje me detyrimet për administrimin e informacionit të klasifikuar është **3 (tre)**.

5.4 Nxjerrje e sekretit për informacione të klasifikuara “Sekret Shtetëror”

Në kuadër të zbatimit të masave/aktiviteteve të parashikuara për rritjen e njohurive mbi administrimin e informacionit të klasifikuar janë ndërmarrë trajnime për punonjësit e rinj lidhur me detyrimet që rrjedhin nga pajisja me certifikatë sigurie dhe menaxhimi i informacionit të klasifikuar.

Gjatë periudhës së raportimit, nga struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit janë trajnuar gjithsej **3 (tre) punonjës**. Këto masa synojnë forcimin e ndërgjegjësimit profesional dhe parandalimin e rasteve të nxjerrjes së paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

5.5 Përmirësimi i menaxhimit të dosjeve

Në kuadër të përmirësimit të performancës institucionale, një komponent i rëndësishëm përbën menaxhimi i dosjeve dhe dokumentacionit, si dhe orientimi drejt zbatimit të një sistemi të automatizuar për administrimin e tyre, i shoqëruar me trajnime të vazhdueshme të stafit mbi menaxhimin dhe ruajtjen e informacionit.

Në lidhje me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, Ministria e Punëve të Brendshme ka implementuar, që prej muajit shtator 2025, një sistem të automatizuar për administrimin e dokumentacionit, nëpërmjet të cilit regjistrohen në formë të skanuar të gjitha shkresat hyrëse dhe dalëse, të administruara nga struktura përgjegjëse e Arkiv-Protokollit me një total prej 16 377 dosje të administruara.

OBJEKTIVI 6: RITJIA E INTEGRITETIT PËRMES TRANSPARENCËS SË SHITUAR DHE TË PLOTË INSTITUCIONALE

Objektivi i rritjes së integritetit në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët synon përmirësimin e ofritit të shërbimeve publike përmes rritjes së transparencës, efikasitetit dhe integritetit institucional. Ky objektiv ka për qëllim parandalimin e korrupsionit, forcimin e besimit të qytetarëve në administratën publike dhe garantimin e një aksesit më të lehtë, më të sigurt dhe më të besueshëm në trajtimin e kërkesave të qytetarëve. Njëkohësisht, ky objektiv kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, duke i bërë ato më të shpejta, më të aksesueshme dhe më transparente.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **8 risqe**, për të cilat janë planifikuar gjithsej **11 masa specifike**, të zbatuara nga strukturat përgjegjëse në kuadër të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët dhe shërbime të tjera.

Nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve përkatëse, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim:

- Rritja e besimit të publikut në opinionin publik;
- Krijimi i rubrike të veçantë në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
- Caktimi i pikave të kontaktit për çdo strukturë, sipas fushave të përgjegjësisë, me qëllim garantimin e koordinimit në kohë dhe me cilësi në trajtimin e kërkesave për informacion;
- Rritja e kontroleve të brendshme me qëllim shmangien e situatave favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale;

Gjatë periudhës së raportimit, nga struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit janë trajnuar gjithsej **3 (tre) punonjës**. Këto masa synojnë forcimin e ndërgjegjësimit profesional dhe parandalimin e rasteve të nxjerrjes së paautorizuar të informacionit të klasifikuar.

5.5 Përmirësimi i menaxhimit të dosjeve

Në kuadër të përmirësimit të performancës institucionale, një komponent i rëndësishëm përbën menaxhimi i dosjeve dhe dokumentacionit, si dhe orientimi drejt zbatimit të një sistemi të automatizuar për administrimin e tyre, i shoqëruar me trajnime të vazhdueshme të stafit mbi menaxhimin dhe ruajtjen e informacionit.

Në lidhje me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara, Ministria e Punëve të Brendshme ka implementuar, që prej muajit shtator 2025, një sistem të automatizuar për administrimin e dokumentacionit, nëpërmjet të cilit regjistrohen në formë të skanuar të gjitha shkresat hyrëse dhe dalëse, të administruara nga struktura përgjegjëse e Arkiv-Protokollit me një total prej 16 377 dosje të administruara.

OBJEKTIVI 6: RITJIA E INTEGRITETIT PËRMES TRANSPARENCËS SË SHITUAR DHE TË PLOTË INSTITUCIONALE

Objektivi i rritjes së integritetit në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët synon përmirësimin e ofritit të shërbimeve publike përmes rritjes së transparencës, efikasitetit dhe integritetit institucional. Ky objektiv ka për qëllim parandalimin e korrupsionit, forcimin e besimit të qytetarëve në administratën publike dhe garantimin e një aksesit më të lehtë, më të sigurt dhe më të besueshëm në trajtimin e kërkesave të qytetarëve. Njëkohësisht, ky objektiv kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, duke i bërë ato më të shpejta, më të aksesueshme dhe më transparente.

Për realizimin e këtij objektivi janë identifikuar **8 risqe**, për të cilat janë planifikuar gjithsej **11 masa specifike**, të zbatuara nga strukturat përgjegjëse në kuadër të parandalimit të korrupsionit dhe rritjes së integritetit në fushën e shërbimeve të drejtpërdrejta për qytetarët dhe shërbime të tjera.

Nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve përkatëse, për periudhën raportuese janë arritur rezultatet kryesore në vijim:

- Rritja e besimit të publikut në opinionin publik;
- Krijimi i rubrike të veçantë në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Drejtorinë e Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi;
- Caktimi i pikave të kontaktit për çdo strukturë, sipas fushave të përgjegjësisë, me qëllim garantimin e koordinimit në kohë dhe me cilësi në trajtimin e kërkesave për informacion;
- Rritja e kontroleve të brendshme me qëllim shmangien e situatave favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale;

- Zbatimi i procedurave transparente për shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave, si dhe aplikimi i një politike “zero tolerancë” ndaj korrupsionit.

6.1 Krijimi i situatave favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale

Përgjatë periudhës raportuese, bazuar në veprimtarinë e strukturave përgjegjëse për ankesat administrative dhe çështjet gjyqësore, nuk janë identifikuar raste që krijojnë situata favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale, duke rezultuar në **0 (zero)** raste.

6.2 Humbja e besimit në opinionin publik

Në kuadër të rritjes së besimit të opinionit publik përfaqësuesit ligjorë të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë angazhuar për sigurimin e një përfaqësimi dinjitoz dhe profesional në qëndrimet institucionale, me qëllim minimizimin e çdo keqinterpretimi të pozicionit të institucionit. Për periudhën raportuese, struktura përgjegjëse evidenton se numri i rasteve të identifikuara rezulton **0 (zero)**.

6.3 Dhënia e informacioneve konfidenciale personave të paautorizuar gjatë procesit gjyqësor

Në lidhje me zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara struktura përgjegjëse për ankesat administrative dhe çështjet gjyqësore, për periudhën raportuese, evidenton se numri i rasteve të identifikuara që kanë kërkuar ndërhyrje apo trajnim në fushën e informacionit të klasifikuar rezulton **0 (zero)**.

6.4 Mungesa e informacionit të plotë ose kontradiktor dhe mos përgjigja nga disa struktura

Struktura përgjegjëse për jetësimin e prioritetëve ka konstatuar se, përgjatë periudhës raportuese ka një përmirësim të angazhimit dhe funksionimit të strukturave raportuese, gjë e cila ka bërë të panevojshëm hartimin e një urdhri të veçantë për rregullimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërstrukturor. Monitorimi javor i kthimit të përgjigjeve përmes postës elektronike ka treguar përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së informacionit dhe respektim të afateve, duke reflektuar reagime në kohë dhe, në disa raste, përpara afatit të përcaktuar.

6.5 Mungesa e bashkëpunimit efektiv dhe dhënia e informacionit jo të plotë për qytetarët

Në zbatim të masave dhe aktiviteteve të planifikuara, janë caktuar pika kontakti nga strukturat me qëllim garantimin e koordinimit në kohë dhe me cilësi në trajtimin e kërkesave për informacion. Struktura përgjegjëse e jetësimit të prioritetëve përgjatë periudhës raportuese ka konstatuar se në shumicën e strukturave bashkëpunimi është përmirësuar ndjeshëm, duke reflektuar rritje të përgjegjshmërisë, bashkëpunimit dhe cilësisë së kthimit të përgjigjeve ndaj qytetarëve.

6.6 Mungesa e një faqeje zyrtare të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH)

Në vijim të krijimit të një faqeje zyrtare të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, informacionet, njoftimet dhe aktivitetet, publikohen përmes një rubrike të dedikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkretisht <https://mb.gov.al/?s=MZSH>.

6.7 Trajtimi i rasteve përmes platformës “Për Shqipërinë që Duam” dhe adresimi i vonesave nga e-Albania

Në kuadër të realizimit të masës 6.7, ky risk është adresuar përmes trajtimit të ankesave të qytetarëve në platformën e bashkëqeverisjes, duke mundësuar koordinimin ndërmjet strukturave të brendshme të MPB-së pa nevojën që qytetari të orientohet drejtpërdrejt në Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Në kuadër të zbatimit të masave/aktiviteteve janë caktuar pika kontakti dhe është përmirësuar koordinimi për trajtimin e ankesave që vijnë nga platforma e bashkëqeverisjes.

Punonjësi i MPB-së, i caktuar për protokollin e platformës së bashkëqeverisjes, ngarkon në platformë ankesat e qytetarëve të pranuar përmes postës elektronike dhe bashkëpunon me pikën e kontaktit të caktuar nga DPGJC për trajtimin e tyre. Monitorimi i zbatimit të masës tregon rritje të efikasitetit, shkurtim të kohës së trajtimit të kërkesave, zgjidhje brenda kornizës ligjore dhe rritje të besueshmërisë së qytetarëve ndaj institucionit, të vlerësuara përmes e-maileve falënderuese të qytetarëve pas përfundimit të trajtimit të rasteve.

6.8 Ndërhyrje e jashtme në procedurat e shqyrtimit të kërkesave për azil

Në përputhje me politikat e azilit janë zbatuar procedura transparente, sisteme monitorimi dhe auditimi të brendshëm, si dhe politika e “zero tolerancës” ndaj korrupsionit. Për periudhën raportuese, struktura përgjegjëse për politikat e azilit ka evidentuar **0 (zero)** auditime, **0 (zero)** raste korrupsioni dhe **0 (zero)** devijime nga procedurat ligjore.

OBJEKTIVI 7: RITJA E INTEGRITETIT PËRMES KOORDINIMIT NË HARTIMIN DHE KUADRIN LIGJOR DHE STRATEGJIK

Objektivi i rritjes së integritetit përmes koordinimit në hartimin dhe kuadrin ligjor dhe strategjik synon garantimin e një qasjeje të unifikuar dhe të koordinuar në të gjitha fazat e procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të kuadrit ligjor dhe strategjik. Ky objektiv kontribuon në rritjen e koherencës institucionale, përmirësimin e cilësisë së procesit vendimmarrës dhe forcimin e integritetit në ushtrimin e funksioneve publike.

Për realizimin e këtij objektivi është identifikuar **1 fushë me risk**, për të cilën janë planifikuar gjithsej **3 masa specifike**, të zbatuara nga strukturat përgjegjëse për hartimin e politikave.

Nëpërmjet zbatimit të masave dhe aktiviteteve përkatëse, për periudhën raportuese janë arritur këto rezultate kryesore:

- realizimi në kohë i raporteve periodike të monitorimit/vlerësimit të zbatimit të dokumenteve strategjike të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe planeve të veprimit.

7.1 Mosrealizimi në kohë i raporteve periodike të monitorimit në zbatim të Strategjive Kombëtare /Ndërsektoriale

Me qëllim respektimin e afateve të përcaktuara për raportim dhe sigurimin e plotësisë së informacionit, vijon të mbetet sfida koordinimi dhe reagimi në kohë nga të gjitha strukturat kontribuuese. Në këtë kuadër, është bërë e nevojshme ndjekja e vazhdueshme e procesit përmes dërgimit të rikujtesave periodike dhe kërkesave shtesë për plotësim apo saktësim informacioni.

Gjatë periudhës raportuese, strukturat përgjegjëse për politikën kanë hartuar dhe dorëzuar në kohë raportet e monitorimit dhe vlerësimit të strategjive, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave përmes sistemit IPSIS dhe brenda afateve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.

Në vijim të këtij procesi, pas miratimit të raporteve përkatëse, janë zhvilluar takime ndërinstitucionale me pjesëmarrjen e institucioneve përgjegjëse dhe kontributore, me qëllim identifikimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të strategjive, si dhe përcaktimin e masave konkrete për adresimin dhe zgjidhjen e tyre në mënyrë të koordinuar.

Ky proces ka kontribuar në përmirësimin e cilësisë së raportimit, rritjen e përgjegjshmërisë institucionale dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të dokumenteve strategjike.

1.3 REKOMANDIME DHE KONKLUSIONE

1.3.1 KONKLUSIONE

Raporti i monitorimit për periudhën korrik–dhjetor 2025 paraqet një pasqyrë të përgjithshme të masave të ndërmarra nga strukturat e aparatit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe institucioneve të varësisë për rritjen e integritetit institucional, duke adresuar dhe minimizuar në mënyrë më të qëndrueshme risqet sipas fushave të identifikuar.

Në fushën e prokurimit publik janë ndërmarrë masa konkrete për forcimin e transparencës dhe reduktimin e rreziqeve të konfliktit të interesit, përmes deklarimit të interesave, përfshirjes së ekspertëve dhe zhvillimit të trajnimeve të dedikuara për stafin. Struktura përgjegjëse për shërbimet mbështetëse ka zbatuar masat e nevojshme për parandalimin e konfliktit të interesit dhe garantimin e konfidencialitetit në procedurat e prokurimit publik, përmes plotësimit të deklarave përkatëse për çdo procedurë, si dhe zhvillimit të trajnimeve për 5 punonjës. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 22 procedura prokurimi, nga të cilat 17 procedura me blerje të vogla dhe 5 procedura për blerjen e biletave të transportit ajror. Nga

monitorimi i kryer nga ana e tyre nuk është konstatuar asnjë rast i shkeljes së konfidencialitetit apo i praktikave të papërshtatshme në procedurat e prokurimit publik.

Në strukturat e inspektimeve dhe licencave, rreziqet që lidhen me inspektimet preferenciale dhe abuzimet janë ulur ndjeshëm falë digjitalizimit të procedurave dhe rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional, duke garantuar kontroll më efektiv dhe transparencë më të lartë. Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit gjatë vitit 2025 janë zhvilluar trajnime periodike në Akademinë e Sigurisë për punonjësit e strukturave vendore të MZSH-së, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale dhe njohurive ligjore. Në total, morën pjesë dhe u certifikuan 155 punonjës në kurse për gradat “Zjarrfikës”, “Asistent Zjarrfikës”, “Kryezjarrfikës” dhe “Inspektor Zjarrfikës”. Struktura përgjegjëse për politikën e azilit, në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, ka siguruar aksesin e azilkërkuesve në informacion mbi procedurat e aplikimit për azil përmes materialeve informuese dhe burimeve elektronike pranë strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit dhe Qendrës Kombëtare për Pritjen e Azilkërkuesve. Gjatë periudhës raportuese nuk është regjistruar asnjë ankesë lidhur me mungesën e informacionit apo orientimit për këto procedura. Struktura përgjegjëse për politikën e shtetësisë ka administruar dhe trajtuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi, 678 aplikime për fitimin, rifitimin dhe heqjen dorë nga shtetësia shqiptare. Për të gjitha rastet janë kryer procedurat administrative dhe verifikimet ndërinstytucionale përkatëse, si dhe janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për përcjelljen e tyre pranë institucioneve kompetente.

Në menaxhimin e burimeve njerëzore janë marrë masa në minimizimin e ndikimeve të jashtme në proceset e rekrutimit dhe promovimit, përmes standardizimit dhe monitorimit të proceseve, si dhe transparencës në çdo fazë të konkurrimit. Struktura përgjegjëse për burimet njerëzore ka identifikuar dhe adresuar nevojat për trajnim të stafit, duke i përcjellë ato pranë ASPA-së. Gjatë periudhës raportuese, punonjësit kanë marrë pjesë në rreth 67 trajnime brenda dhe jashtë vendit, sipas fushave të përgjegjësisë. Gjithashtu, me qëllim promovimin e një klime pozitive në institucion, është organizuar një aktivitet social për fëmijët e punonjësve me rastin e festave të fund vitit.

Në menaxhimin financiar janë reduktuar rreziqet e mospërputhjes dhe keqadministrimit përmes planifikimit më të mirë buxhetor dhe forcimit të kontrolleve të brendshme. Struktura përgjegjëse për buxhetin ka siguruar planifikimin buxhetor mbi bazën e analizës së viteve paraardhëse, në përputhje me prioritetet institucionale, dokumentet strategjike dhe kapacitetet reale të realizimit. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar raporte monitorimi mujore dhe tremujore, ndërsa rialokimet buxhetore janë kryer mbi bazë argumentimi të arsyetuar, duke rezultuar në uljen e përqindjes së tyre në 10% krahasuar me vitin 2024. Gjithashtu, është monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimi i projekteve dhe investimeve, ku 90% e projekteve të financuara lidhen drejtpërdrejt me prioritetet strategjike, si dhe është siguruar trajnimi i stafit për planifikimin dhe menaxhimin buxhetor.

Në fushën e transparencës, struktura përgjegjëse për jetësimin e prioritetëve ka siguruar përditësimin e rregullt të CV-ve të funksionarëve politikë dhe drejtuesve të nivelit të lartë të shërbimit civil në faqen zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në përputhje me kërkesat për transparencë dhe procedurat

e brendshme. Gjithashtu, është garantuar publikimi i informacionit mbi profilin, veprimtarinë dhe fushat e përgjegjësisë së këshilltarëve politikë, përmes seksioneve përkatëse të aksesueshme në faqen zyrtare të institucionit.

Në drejtim të sigurisë së informacionit dhe dokumentacionit të klasifikuar janë ndërmarrë masa shtesë, përfshirë trajnime specifike, duke parandaluar humbjen apo aksesin e paautorizuar.

Digjitalizimi i shërbimeve publike ka ndikuar në uljen e gabimeve dhe vonesave, duke rritur efikasitetin dhe aksesin për qytetarët. Gjithashtu, trajnimet mbi etikën dhe mekanizmat e sinjalizimit të korrupsionit kanë ndihmuar në adresimin e sjelljeve me risk brenda institucioneve, duke forcuar mbrojtjen ligjore për sinjalizuesit dhe duke promovuar një kulturë përgjegjshmërie.

Zbatimi i masave rezulton të jetë në proces realizimi dhe përkon me gjashtëmujorin e parë të zbatimit të tyre, periudhë e cila karakterizohet nga faza fillestare e implementimit dhe konsolidimit të mekanizmave përkatës. Në këtë fazë, shumica e masave janë ende në zhvillim e sipër dhe nuk kanë arritur ende në stadin e përfundimit apo të prodhimit të rezultateve të plota dhe të matshme. Për rrjedhojë, nuk është ende e mundur të përcaktohet në mënyrë e plotë dhe përfundimtare niveli i realizimit në përqindje, si dhe të bëhet një klasifikim i qartë i tyre në masa të realizuara, në proces apo të përealizuara. Ky vlerësim pritet të bëhet i mundur në periudhat pasuese raportuese, nëpërmjet një monitorimi të vazhdueshëm dhe të strukturuar, i cili do të mundësojë një analizë më të thelluar dhe të bazuar në rezultate konkrete.

1.3.2 REKOMANDIME

Në mbështetje të analizës së realizimit të objektivave dhe masave të Planit të Integritetit për periudhën raportuese, si dhe duke vlerësuar progresin e arritur në drejtim të forcimit të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit institucional, paraqiten rekomandimet si më poshtë:

Në kuadër të rritjes së integritetit në fushën e prokurimit publik, struktura përgjegjëse për Shërbimet Mbështetëse duhet:

- të vijojë zhvillimin e trajnimeve periodike për punonjësit, me qëllim përmirësimin e aftësive profesionale dhe njohurive ligjore për një interpretim dhe zbatim të saktë të kuadrit ligjor;
- të vijojë rritjen e transparencës në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, ku çdo procedurë të shoqërohet me deklarata të konfliktit të interesit, duke garantuar trajtim të barabartë për operatorët ekonomikë dhe respektimin e konkurrencës së lirë;
- të garantojë përfshirjen e ekspertëve në proceset komplekse të prokurimit për të garantuar një qasje profesionale dhe të saktë ndaj përcaktimit të kriterëve dhe specifikimeve teknike.

Në kuadër të rritjes së integritetit në fushën e inspektimeve/ kontrolleve dhe lëshimit të licencave e certifikimeve:

- strukturat përgjegjëse të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit të vijnë kryerjen e inspektimeve në lidhje me zbatimin e rregullave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në nivel vendor;
- struktura përgjegjëse për politikën e shtetësisë të vijnë shqyrtimin në kohë të aplikimeve për fitimin, lënien dhe rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe respektimi i afatave ligjore të procedurave nga struktura përgjegjëse për politikën e shtetësisë;
- të vijnë rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet strukturës përgjegjëse për Politikën e Shtetësisë dhe institucioneve partnere për verifikimin e kërkesave për fitim dhe rifitim të shtetësisë.
- të vijnë përdorimi i teknikave të përshtatshme për vlerësimin e kërkesave për azil, me qëllim qartësimin dhe thjeshtimin e procedurave të aplikimit nga struktura përgjegjëse për politikën e azilit.

Në kuadër të rritjes së integritetit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore strukturat përgjegjëse të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të aparatit, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin duhet:

- të vijnë zbatimin e politikave të integritetit dhe etikës për stafin;
- të vijnë krijimin e një atmosfere bashkëpunuese dhe pozitive në vendin e punës;
- të vijnë përditësimin e publikimit të informacionit mbi këshilltarët politikë, profilizimin dhe veprimtarinë e tyre në faqen zyrtare të institucionit;
- të vijnë zhvillimin e trajnimeve intensive për nëpunësit e gjendjes civile, me fokus në përditësimet e legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të rritjes së integritetit në fushën e menaxhimit financiar, të aseteve, të projekteve:

- të vijnë rritja e transparencës në planifikimin afatgjatë dhe afatshkurtër të shpenzimeve buxhetore nga struktura përgjegjëse e buxhetit;
- të vijnë respektimi i afatave ligjore në procedurat e prokurimit publik nga struktura përgjegjëse të Financës;
- të vijnë forcimi i mekanizmave për administrimin, monitorimin dhe mbrojtjen e pronave publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e aseteve;
- të vijnë shpërndarja e buxhetit në përputhje me prioritetet e përcaktuara nga Këshilli i Ministrave nga struktura përgjegjëse e buxhetit;
- të vijnë trajnimi i stafit me qëllim rritjen e efikasitetit në përdorimin e fondeve publike, përmirësimin e analizave dhe raporteve mbi risqet, si dhe reduktimin e numrit të rialokimeve krahasuar me vitin paraardhës nga struktura përgjegjëse e buxhetit; dhe struktura përgjegjëse e Financës.

Në kuadër të rritjes së integritetit përmes transparencës së shtuar dhe të plotë institucionale:

- të vijnë rritja e kontroleve të brendshme me qëllim shmangien e situatave favorizuese ose lehtësirave në gjykim, bazuar në interesa private apo lidhje personale nga struktura përgjegjëse për çështjet administrative dhe çështjet gjyqësore;

- të vijojë marrja e masave për parandalimin e humbjes së besimit në opinionin publik nga struktura përgjegjëse për çështjet administrative dhe çështjet gjyqësore;
- të vijojë kryerja e trajnimeve mbi përdorimin e informacionit të klasifikuar nga struktura përgjegjëse për arkiv-protokollin.

Në kuadër të rritjes së integritetit përmes koordinimit në hartimin dhe kuadrin ligjor dhe strategjik:

- të vijojë realizimi i raporteve të monitorimit/vlerësimit të strategjive brenda afateve të parashikuara, dhe zhvillimi i takimeve ndër-institucionale mbi evidentimin e problematikave apo gjetjeve nga strukturat përgjegjëse të politikave, me qëllim marrjen e masave korrigjuese në kohë dhe mbajtjen të informuar të nivelit vendimmarrës.